

Drejtoria e Gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren
Nr.prot: 186 datë:04.02.2026

Bazuar në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 të dt. 12.01.2016, vendimin me nr. 184 të datës 03.02.2026 nga KDSH, drejtoria e gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencitë turistike organizatorë të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të gjinnazit "Gjon Buzuku" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datën **04.05.2026** deri më **08.05.2026**.

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Kriteret e përgjithshme

- Të jetë i licensuar;
- Certifikata e agjencionit transportues
- Të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore,
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore,
- Certifikata e autobusit sipas licencës D
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës mbi 300 vende
- Autobusët të jenë komforë dhe me klimë,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit
- Agjencioni duhet të sigurojë mjekun për përkujdesje mjekësore për nxënësit, të jetë i diplomuar dhe të ketë licencë pune.
- Dëshmi për rezervimin e hotelit për datat 04.05.2026 deri më 08.05.2026.
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
- Certifikatat e shoferëve (CPC)
- Referencat rreth organizimit të ekskursionit për tri vite të fundit,
- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë
- Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit (2023, 2024 dhe 2025) së paku 300 000 euro.
- Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit nr.telefonit i pronarit dhe adresa të përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë mbi 300 shtretër. Të posedojë rrethojë dhe i siguruar nga personeli i sigurimit të hotelit për të garantuar siguri për nxënë. Gjithashtu hoteli të posedoj banjo dhe ujë të mjaftueshëm përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallën e ushqimit me hapsirë të mjaftueshme mbi 300 vende për ushqim në tri vaktet kriter i përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallë për argëtim për nxënë dhe të mos shërbehet apo lejojë shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike në tërë hapësirën e hotelit KDSH
- Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënë përcaktuar nga KDSH.
- Të prezantohet mënyja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për pesë ditë qëndrimi KDSH
- Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta nga hoteli dhe pagesa hyrëse nëpër monumente nga kompania sipas itinerarit kriter i KDSH.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion kriter i KDSH.
- Oferta për nxënësit të liruar nga pagesa KDSH

Vërejtje- Kompania Turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet të siguroj nënshkrime nga Drejtoresha e shkollës, përfaqësuesi i Këshillit të prindërve, përfaqësuesi i këshillit të nxënësve për përmbushjen e kushteve të përcaktuara sipas kriterëve të lartëcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

P.s. Lartësia e pagesës 160 euro

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimit mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë. Hapjen e ofertave e bëjnë komisioni sipas UA 02/2016 me datë 10.02.2026, **në ora 16:00** në ambientet e DKA Prizren ku mund të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, komisioni do të verifikojë dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kompanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.

Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.